

**Data 30.06.2026**

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE - Mbi kufirin e lartë monetar -  
Prokurim me mjete elektronike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 3”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për autostrada, rrugë 45233100-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,364,927,749.30** (një miliard e treqind e gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë tridhjetë) **Lekë pa TVSH;**

**Në Euro: 14,495,834.21** (katërmëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër pikë njëzet e një) **Euro pa TVSH.**

Në bazë të *Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024* Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 (*Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026*). Bazuar në *Nenin 42, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar) “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”*. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte rrisje të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të *pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021*

“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në një gazetë zyrtare të Bashkimit Europian.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (**Datë 29.06.2026, ora 12:06:10**)  
**1 Lek = 94.16 Euro**

---

➤ Në DST është përcaktuar:

**Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:**

### **2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

**Po**

**X**

**Jo**

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**punë të ngjashme**):
  - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):
  - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

### **Argumentimi ligjor:**

Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Nenit 90, pikat 5 dhe 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se për aspektet kritike të kontratës nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për këtë procedurë prokurimi, si aspekte kritike janë konsideruar:

- Përvoja e mëparshme e ngjashme, sipas pikës 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit;

- Licenca profesionale për realizimin e punimeve objekt kontrate, sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

### ***Argumentimi teknik:***

Objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore rrugore me vlerë të konsiderueshme financiare, kompleksitet teknik dhe rëndësi të veçantë publike. Për realizimin me sukses të kontratës është e nevojshme që operatori ekonomik, i cili do të marrë përsipër ekzekutimin e drejtpërdrejtë të punimeve dhe do të mbajë përgjegjësinë kontraktore ndaj Autoritetit Kontraktor, të disponojë vetë eksperiencën e nevojshme profesionale dhe licencat përkatëse të kërkuara për realizimin e punimeve.

Përvoja e ngjashme përbën një tregues të drejtpërdrejtë të aftësisë teknike, organizative dhe profesionale të operatorit ekonomik për të planifikuar, administruar dhe realizuar kontrata me natyrë, përmasa dhe kompleksitet të krahasueshëm me objektin që prokurohet. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo përvojë duhet të zotërohet nga vetë operatori ekonomik ose nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojnë kontratën, dhe jo nga subjekte të treta që nuk do të marrin pjesë në ekzekutimin e drejtpërdrejtë të punimeve.

Po kështu, licenca profesionale e shoqërisë përfaqëson aftësinë ligjore dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë ndërtimore në kategoritë përkatëse të punimeve. Kategoritë dhe klasat e licencës fitohen mbi bazën e eksperiencës së shoqërisë, kapaciteteve financiare, strukturës teknike dhe eksperiencës profesionale të personelit drejtues teknik. Për rrjedhojë, licenca përfaqëson një atribut të vetë operatorit ekonomik dhe nuk mund të konsiderohet si një kapacitet që mund të huazohet ose të zëvendësohet përmes mbështetjes në subjekte të treta.

Lejimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto aspekte kritike do të çenonte qëllimin e verifikimit të aftësive reale të operatorit ekonomik që do të ekzekutojë kontratën dhe do të rriste riskun e mosrealizimit të punimeve sipas standardeve, afateve dhe kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor ka respektuar parimin e konkurrencës së lirë, pasi nuk kufizon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurë në formën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku secili anëtar kontribuon me kapacitetet dhe eksperiencën e tij në realizimin e kontratës.

➤ **Në DST është përcaktuar**

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto <sup>1</sup> X**

Sipas rëndësisë:

<b>Çmimi</b> <input type="checkbox"/>	<b>pikët 60</b>
<b>Metodologjia</b> <input type="checkbox"/>	<b>pikët 5</b>
<b>Stafi / Organizimi i Kompanisë</b> <input type="checkbox"/>	<b>pikët 15</b>
<b>Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social</b> <input type="checkbox"/>	<b>pikët 10</b>
<b>Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit</b> <input type="checkbox"/>	<b>pikët 10</b>

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto**

**Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ [kriteri 1, 5 a) dhe 5 b)] e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2, 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

**1. Çmimi [60 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{k1}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

---

<sup>1</sup>Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

### ***Argumentimi:***

Kriteri i çmimit është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.*

Duke qenë se objekti i prokurimit përbën një investim publik me vlerë të konsiderueshme financiare dhe financohet nga Buxheti i Shtetit, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se elementi ekonomik duhet të ketë peshën kryesore në vlerësimin e ofertave. Për këtë arsye, çmimit i është atribuar pesha prej 60 pikësh, duke garantuar respektimin e parimeve të efektivitetit dhe përdorimit me eficiencë të fondeve publike.

Formula e vlerësimit siguron trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencë dhe proporcionalitet në vlerësimin e ofertave, duke favorizuar ofertat me kosto më të ulët pa neglizhuar elementët cilësorë që ndikojnë në realizimin e investimit.

## **2. Metodologjia [5 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

*Faktorët favorizues:* Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

*Pajisje inovative:* Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

*Metodologji punimesh:* Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

### ***Argumentimi:***

Kriteri i metodologjisë është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Për shkak të kompleksitetit teknik të punimeve rrugore dhe afatit të realizimit prej 24 muajsh, mënyra e organizimit dhe zbatimit të punimeve përbën një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e kontratës. Metodologjia e propozuar nga operatori ekonomik mundëson vlerësimin e qasjes teknike që do të ndiqet për realizimin e punimeve, organizimin e burimeve njerëzore dhe

teknike, koordinimin e aktiviteteve në kantier, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe respektimin e grafikut të punimeve.

Gjithashtu, përdorimi i teknologjive moderne, makinerive bashkëkohore dhe praktikave inovative të ndërtimit mund të ndikojë pozitivisht në cilësinë e punimeve, sigurinë në kantier dhe optimizimin e afateve të realizimit. Për këtë arsye, metodologjia konsiderohet element cilësor me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kontratës.

### **3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin **2.3** / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

\*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

\*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin

Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

**Argumentimi:**

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285/2021, të ndryshuar*. Objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore me vlerë të konsiderueshme dhe procese të shumta teknike që kërkojnë menaxhim profesional, koordinim të vazhdueshëm dhe mbikëqyrje të specializuar. Formimi akademik, eksperiencia profesionale dhe eksperiencia në projekte të ngjashme të stafit kyç përbëjnë tregues të drejtpërdrejtë të kapacitetit të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën sipas kërkesave teknike dhe afateve të përcaktuara. Në mënyrë të veçantë, eksperiencia në kontrata me natyrë dhe kompleksitet të ngjashëm është një element me vlerë të shtuar, pasi dëshmon aftësinë reale të personelit për të përballuar problematika teknike, organizative dhe logjistike të krahasueshme me ato të kontratës objekt prokurimi. Gjithashtu, organigrama e propozuar dhe mënyra e organizimit të stafit mundësojnë vlerësimin e efektivitetit të strukturës menaxheriale dhe teknike që do të përdoret gjatë zbatimit të kontratës.

**4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

**Argumentimi:**

Punimet objekt kontrate përfshijnë aktivitete ndërtimore me ndikim të mundshëm në mjedis dhe në komunitetin ku do të zhvillohet investimi.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatorët ekonomikë të paraqesin masa konkrete dhe të verifikueshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale gjatë fazës së ndërtimit.

Ky kriter synon të promovojë përdorimin e materialeve me ndikim më të ulët mjedisor, makinerive me efikasitet më të lartë energjetik, menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, kontrollin e pluhurave dhe zhurmave, si dhe zbatimin e masave parandaluese të parashikuara në dokumentacionin mjedisor të projektit.

Gjithashtu, vlerësohen iniciativat që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të zonës së projektit, veçanërisht nëpërmjet punësimit të banorëve lokalë dhe përfshirjes së tyre në procesin e realizimit të investimit.

Duke qenë se kontrata ka ndikim të drejtpërdrejtë në territor dhe komunitet, ky kriter lidhet ngushtë me realizimin e qëndrueshëm të investimit dhe përmbushjen e objektivave mjedisore e sociale të projektit.

## 5. Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

a) Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [5 pikë]  
Kjo, në mbështetje të *Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit"*.

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{\max k1} / V_{\max k1}$$

$V_{\max k1}$  Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k1}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Periudha e mirëmbajtjes rutinë në përputhje me periudhën e garancisë [5 pikë]

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{\max k1} / V_{\max k1}$$

$V_{\max k1}$  Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k1}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.**

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

### ***Argumentimi:***

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45 të VKM Nr. 285/2021, të ndryshuar*, si dhe kërkesave të legjislacionit teknik për ndërtimin dhe kolaudimin e punimeve.

Periudha e garancisë përbën një tregues të drejtpërdrejtë të besimit që operatori ekonomik ka mbi cilësinë e punimeve dhe materialeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Ofrimi i një periudhe garancie dhe mirëmbajtjeje më të gjatë krijon garanci shtesë për Autoritetin Kontraktor lidhur me performancën e objektit pas përfundimit të punimeve dhe ul rrezikun e kostove shtesë për riparime ose ndërhyrje korrigjuese.

Për një investim rrugor me një vlerë mbi 1 miliard lekë dhe jetëgjatësi të pritshme shumëvjeçare, garantimi i funksionalitetit dhe cilësisë së veprës edhe pas dorëzimit të saj paraqet interes të veçantë publik.

Për këtë arsye, operatorët ekonomikë që ofrojnë periudha më të gjata garancie dhe mirëmbajtjeje vlerësohen me më shumë pikë, duke nxitur paraqitjen e ofertave me cilësi dhe përgjegjësi më të lartë ndaj investimit publik.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe mirëmbajtjeje rutinë, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

---

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;*

### ***Argumentimi:***

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8**

### ***Argumentimi:***

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 10 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

### ***Argumentimi:***

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 1 dhe 2, gërma “a”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter synon të verifikojë kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë për të realizuar kontratën objekt prokurimi dhe për të përballuar angazhimet financiare që lidhen me ekzekutimin e punimeve. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin punë publike, realizimi i saj kërkon disponimin e burimeve të mjaftueshme financiare për sigurimin e materialeve të ndërtimit, makinerive dhe pajisjeve, fuqisë punëtore, si dhe përballimin e shpenzimeve operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë të provojnë një nivel të përshtatshëm aktiviteti ekonomik dhe stabiliteti financiar, i cili garanton aftësinë për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Vlera e kërkuar e xhiros është përcaktuar në masën 100% të vlerës së fondit limit, nivel i cili është më i ulët se kufiri maksimal i lejuar nga *Neni 43, pika 2, gërma “a”, i VKM Nr. 285/2021*. Ky përcaktim respekton parimin e proporcionalitetit dhe synon të garantojë njëkohësisht pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe përzgjedhjen e operatorëve që disponojnë kapacitetin e nevojshëm financiar për realizimin me sukses të kontratës.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e xhiros vjetore mbështetet në të dhënat financiare dhe tatimore të deklaruara nga operatorët ekonomikë në përputhje me *Ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin Nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar, të cilat përcaktojnë mënyrën e deklarimit dhe raportimit të të dhënave financiare dhe tatimore të subjekteve ekonomike.*

---

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të parqiten konform parashikimit të *Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, i ndryshuar), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

#### ***Argumentimi:***

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, si dhe *Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar.

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin punë publike, realizimi i kontratës kërkon një gjendje financiare të qëndrueshme, e cila garanton aftësinë e operatorit ekonomik për të siguruar materialet e nevojshme, makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, fuqinë punëtore, si dhe për të përballuar shpenzimet operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të provuar një aktivitet ekonomik të qëndrueshëm dhe një gjendje financiare të shëndoshë të operatorit ekonomik, duke minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës dhe duke garantuar vazhdimësinë normale të punimeve deri në përfundimin e tyre.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, *Ligjit nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat"*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare vjetore.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.**

#### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
  - Aktin e kolaudimit

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
  - Akt kolaudimi objekti

**Shënim:** *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

**2.3.1/2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

**2.3.1/3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

### **Argumentimi:**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"*, të ndryshuar, si dhe të *VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin e përvojës së ngjashme me qëllim verifikimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Objekti i kësaj procedure përfshin punime për ndërtim/rikonstrukcion rrugor, të cilat karakterizohen nga procese teknike të specializuara, si punime gërmimi, mbushje e ngjeshje, ndërtim shtresash rrugore, asfaltim, sistemim e disiplinim ujërash, sinjalistikë rrugore, masa sigurie rrugore, koordinim i proceseve të punës me qarkullimin e mjeteve dhe menaxhim i një numri të konsiderueshëm makinerish, pajisjesh dhe personeli teknik.

Për shkak të kompleksitetit teknik dhe rëndësisë së këtyre punimeve për sigurinë rrugore dhe interesin publik, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të provojnë se kanë realizuar më parë kontrata të ngjashme dhe se disponojnë eksperiencën e duhur për organizimin, drejtimin dhe përfundimin me sukses të punimeve të kësaj natyre.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë realizuar një kontratë të vetme të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit ose kontrata të ngjashme me vlerë totale jo më të vogël se dyfishi i fondit limit gjatë pesë viteve të fundit, është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara të konkurrencës. Kjo kërkesë synon të garantojë se operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme teknike, organizative dhe financiare për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara.

Parashikimi i dy alternativave për përmbushjen e kriterit rrit mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurë, duke lejuar kualifikimin si të operatorëve që kanë realizuar një kontratë të vetme me përmasa të konsiderueshme, ashtu edhe të operatorëve që kanë fituar eksperiencë të krahasueshme nëpërmjet realizimit të disa kontratave të ngjashme.

Dokumentacioni i kërkuar për provimin e eksperiencës së mëparshme është i nevojshëm për të verifikuar realizimin efektiv të punimeve, vlerën e tyre, cilësinë e ekzekutimit dhe përfundimin me sukses të kontratave të paraqitura si referencë. Këto dokumente krijojnë bindjen e arsyeshme se operatori ekonomik disponon eksperiencën dhe kapacitetin e nevojshëm për realizimin e investimit rrugor objekt prokurimi.

Për rrjedhojë, kriteri është në raport të drejtë me natyrën, përmasat, kompleksitetin teknik dhe vlerën e kontratës që prokurohet, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe*

*disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

### 2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-D	Punime gjermimi në tokë
2	NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5-F	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-7-A	Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi dhe vaditje
5	NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
6	NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
7	NS-6-A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
8	NS-7-B	Barriera dhe mbrojtja rrugore
9	NS-18-A	Punime topogjeodezike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), si dhe me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" (të ndryshuar), Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas*

ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-D	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në trupin e rrugës dhe në vepra arti.	101-200 milion	103,408,636.42
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Përfshin gjithë punimet në rrugë.	Mbi 800 milion	1,364,927,749.30
NP-5-F	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime për ndërtimin e urave dhe mureve mbajtëse dhe tombino	401-800 milion	654,492,447.45
NP-7-A	Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe vaditje	Punime për spostim linjash ujësjellësi dhe KUZ.	0-20 milion	18,450,148.56
NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Rikonstruksion rrjeti TU dhe TM dhe ndriçimi rrugor	0-20 milion	12,531,897.03
NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime mjedisore 1% të punimeve	0-20 milion	13,649,277.49
NS-6-A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike	0-20 milion	6,422,491.36

		vertikale dhe horizontale		
NS-7-B	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje guardrail	21-50 milion	21,272,937
NS-18-A	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike 1% të punimeve	0-20 milion	13,649,277.49

**2.3.2/2** Personelin kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), e ndryshuar, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të disponojnë personelin e nevojshëm teknik dhe profesional për realizimin e kontratës, për sa kohë kërkesa lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe është në përpjesëtim me të.

Duke qënë se objekti i kësaj procedure prokurimi është **“Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 3”**, i cili përfshin punime komplekse të infrastrukturës rrugore, punime gërmimi dhe mbushjeje, sistemim e stabilizim të trupit të rrugës, ndërtim të shtresave rrugore, sistemim dhe ndërtim të veprave të kullimit, sinjalistikë rrugore, punime elektrike, si dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë gjatë punimeve.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel drejtues teknik me profile të ndryshme inxhinierike, të cilët garantojnë organizimin, drejtimin, kontrollin teknik dhe cilësinë e zbatimit të punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike dhe legjislacionit në fuqi.

Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile, organizimin e kantierit, kontrollin e cilësisë së punimeve, zbatimin e projektit dhe koordinimin e të gjitha proceseve të ndërtimit.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është i domosdoshëm për kryerjen e rilevimeve topografike, piketimin e aksit rrugor, kontrollin e kuotave, volumeve të gërmimeve dhe mbushjeve, si dhe verifikimin e saktësisë gjeometrike të punimeve.
- **Inxhinieri Gjeolog/Gjeoteknik** kërkohet për vlerësimin e karakteristikave gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit, kontrollin e stabilitetit të trupit të rrugës, verifikimin e shtresave mbajtëse dhe trajtimin e problematikave që lidhen me kushtet e tokës.
- **Inxhinieri Mekanik** kërkohet për organizimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit, kontrollin teknik të tyre, si dhe për realizimin e punimeve që lidhen me elementët mekanikë të veprave të infrastrukturës.
- **Inxhinieri i Mjedisit** është i nevojshëm për monitorimin e zbatimit të masave të mbrojtjes së mjedisit, administrimin e mbetjeve, kontrollin e ndikimeve mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe respektimin e kushteve të lejeve mjedisore.
- **Inxhinieri Hidroteknik** kërkohet për drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve që lidhen me sistemet e drenazhimit, kanalet kulluese, tombinot, veprat e ujërave sipërfaqësore dhe elementët hidraulikë të infrastrukturës rrugore, të cilët janë thelbësorë për funksionimin dhe jetëgjatësinë e aksit rrugor.
- **Inxhinieri Elektrik** kërkohet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve elektrike të parashikuara në projekt, si ndriçimi rrugor, rikonstrukcion rrjeti TU dhe TM

Kërkesa që këta specialistë të jenë pjesë e **personelit kryesor drejtues teknik të licencës së shoqërisë**, të kenë marrëdhënie pune të vlefshme me operatorin ekonomik dhe të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi, synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet reale teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës, duke siguruar vazhdimësinë e drejtimit teknik gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së punimeve, respektimit të afateve kontraktore, zbatimit të standardeve teknike dhe të sigurisë, si dhe minimizimit të rreziqeve teknike gjatë ekzekutimit të kontratës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën, pasi profilet e kërkuara përfaqësojnë personelin minimal të nevojshëm për realizimin e një kontrate për rikonstrukcion të një aksi rrugor.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoresh minimalisht **115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Maj 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Maj 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Maj 2026**.

#### ***Argumentimi:***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri minimal prej 120 (njëqind e njëzet) punonjësish.

Ky kriter është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, fondin limit, kompleksitetin teknik të punimeve rrugore, volumet e konsiderueshme të punimeve të parashikuara në preventiv dhe nevojën për realizimin e tyre brenda afatit kontraktual prej 24 muajsh.

Objekti i kontratës përfshin procese pune të specializuara dhe të ndërthurura, të tilla si: punime gjurmimi dhe mbushjeje, transport materiale, ndërtim të shtresave rrugore, asfaltim, sistemim e disiplinim të ujërave, ndërtim veprash arti, vendosje sinjalistike dhe elementësh të sigurisë rrugore, si dhe aktivitete të tjera ndihmëse e mbështetëse. Realizimi i këtyre proceseve kërkon angazhimin e vazhdueshëm të personelit teknik, specialistëve të fushës, drejtuesve të mjeteve e makinerive dhe fuqisë punëtoresh zbatuese.

Duke qenë se punimet do të zhvillohen në disa procese dhe fronte pune njëkohësisht, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i një fuqie punëtoresh minimale prej 120 punonjësish është i domosdoshëm për të garantuar organizimin efektiv të punës, respektimin e grafikut të zbatimit, përmbushjen e afateve kontraktuale dhe realizimin e investimit sipas standardeve teknike të kërkuara.

Numri i kërkuar i punonjësve është në raport të drejtë me vlerën e kontratës, kohëzgjatjen e saj dhe natyrën e punimeve që do të kryhen dhe nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por një garanci për disponimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të kontratës. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (materiale, punëtori, makineri, transport) zëri i fuqisë punëtore zë rreth 10% të kostos.

Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit nga organet tatimore ose sigurimet shoqërore dhe listëpagesave të muajit Maj 2026 synon verifikimin e ekzistencës reale të fuqisë punëtore të deklaruar nga operatori ekonomik, si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe sigurimeve shoqërore.

**2.3.4** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (**jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë**), si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transport)**
- **1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedis**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- ❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Objekti i kontratës është “Rikonstrukcion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 3”, i cili përfshin një volum të konsiderueshëm punimesh civile, punime të infrastrukturës rrugore, gërmime dhe mbushje, ndërtimin e shtresave rrugore, punime kullimi, sinjalistikë, si dhe punime të tjera ndihmëse të parashikuara në projekt-preventiv. Për shkak të kompleksitetit teknik, kohëzgjatjes së kontratës dhe nevojës për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës, nuk mjafton vetëm disponimi i drejtuesve teknikë të licencës, por kërkohet edhe një staf mbështetës teknik, i cili do të jetë i angazhuar drejtpërdrejt në organizimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e përditshëm të punimeve në kantier.

Në këtë kuadër kërkohet:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**, për organizimin dhe zbatimin e punimeve civile, kontrollin e cilësisë dhe koordinimin e proceseve të ndërtimit në terren.
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transportit)**, për zbatimin teknik të punimeve specifike të infrastrukturës rrugore, kontrollin e zbatimit të shtresave rrugore, parametrave gjeometrikë dhe standardeve teknike të projektit.
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**, për piketimin e aksit, rilevimet topografike, kontrollin e kuotave dhe volumeve të punimeve, si dhe verifikimin e saktësisë së zbatimit të projektit.
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik**, për monitorimin e kushteve gjeoteknike gjatë punimeve, kontrollin e stabilitetit të trupit të rrugës dhe zbatimin e masave teknike sipas projektit.
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**, për organizimin dhe kontrollin teknik të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit, duke garantuar funksionimin normal dhe efektivitetin e tyre gjatë zbatimit të kontratës.

- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**, për monitorimin e respektimit të masave të mbrojtjes së mjedisit, administrimin e mbetjeve të ndërtimit dhe zbatimin e kushteve të lejes mjedisore gjatë realizimit të punimeve.
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**, për zbatimin e punimeve të drenazhimit, kanaleve kulluese, tombinove dhe veprave të tjera hidroteknike të parashikuara në projekt.
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**, për zbatimin e punimeve elektrike të parashikuara në projekt, si ndriçimi rrugor dhe rikonstruksion rrjeti TU dhe TM.

Ky staf mbështetës nuk kërkohet të jetë domosdoshmërisht pjesë e personelit drejtues teknik të licencës së shoqërisë, por duhet të jetë në dispozicion të operatorit ekonomik gjatë zbatimit të kontratës, me qëllim garantimin e kapaciteteve reale profesionale për realizimin cilësor dhe brenda afateve të punimeve.

Gjithashtu, kërkesa që ky staf **të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera në zbatim apo i deklaruar në procedura të shpallura fituese** vendoset për të garantuar disponueshmërinë efektive të personelit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës, duke shmangur mbivendosjen e angazhimeve profesionale që mund të ndikojnë në cilësinë, ritmin dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Ky kusht, synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetet reale njerëzore për realizimin e kontratës dhe është në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe të efektivitetit të zbatimit të kontratës publike.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e *Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

\*\*\* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:**

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore rrugore me vlerë të konsiderueshme financiare, kohëzgjatje 24 muaj dhe angazhim të një numri të lartë punonjësish, makinerish dhe pajisjesh ndërtimi. Për shkak të natyrës së punimeve, ekzistojnë risqe të vazhdueshme që lidhen me sigurinë në punë, aksidentet në kantier dhe situatat emergjente.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson të domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën një specialist të certifikuar për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, i cili garanton reagimin e menjëhershëm në rast aksidentesh apo situatash të paparashikuara gjatë zbatimit të punimeve.

Gjithashtu, disponimi i një punonjësi të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është i nevojshëm për monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve profesionale, kontrollin e kushteve të punës në kantier dhe garantimin e respektimit të kërkesave të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Duke marrë në konsideratë përmasat e investimit, afatin e realizimit dhe numrin e konsiderueshëm të punonjësve të kërkuar për zbatimin e kontratës, ky kriter është proporcional me objektin e prokurimit dhe synon garantimin e sigurisë së personelit, cilësisë së punimeve dhe mbarëvajtjes së procesit të ndërtimit.

Paraqitja e certifikatave përkatëse kërkohet për të provuar kualifikimin profesional të specialistëve dhe aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet ligjore dhe teknike që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa që stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera apo i deklaruar në procedura të shpallura fituese është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, vlerën e konsiderueshme të investimit, afatin e realizimit prej 24 muajsh, si dhe rëndësinë që paraqet garantimi i sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Specialistët e kërkuar në këtë pikë kanë rol të drejtpërdrejtë në menaxhimin e situatave emergjente, zbatimin e masave të sigurisë në kantier, monitorimin e kushteve të punës dhe garantimin e respektimit të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Për shkak të përgjegjësive të tyre specifike dhe nevojës për prani dhe monitorim të vazhdueshëm në objekt, Autoriteti Kontraktor vlerëson se angazhimi i tyre paralel në kontrata të tjera mund të ndikojë negativisht në përmbushjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Duke pasur parasysh se objekti i prokurimit përfshin punime infrastrukturore rrugore me volum të konsiderueshëm punimesh, përdorim të makinerive të rënda, angazhim të një numri të madh punonjësish dhe procese pune me risk të shtuar, është e nevojshme që specialistët përgjegjës për sigurinë dhe emergjencat të jenë plotësisht të disponueshëm për këtë kontratë.

Kjo kërkesë synon të garantojë mbikëqyrjen e vazhdueshme të masave të sigurisë, reagimin në kohë ndaj situatave emergjente, minimizimin e rreziqeve në kantier dhe realizimin e punimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike. Për rrjedhojë, kriteri është në përpjesëtim me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës dhe është vendosur në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe realizimit me sukses të investimit.

**2.3.6** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe *nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, Librezë pune dhe kontratë pune.***

*Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

#### **Argumentimi:**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar detyrimin që operatori ekonomik të disponojë një Drejtues Teknik të Punimeve, me profesion Inxhinier Ndërtimi, i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë.

Ky kriter është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, fondin limit mbi kufirin e lartë monetar, si dhe rëndësinë që paraqet kontrolli teknik, organizimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e proceseve të ndërtimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve. Objekti i kontratës përfshin punime rrugore me volume të konsiderueshme, procese të ndryshme teknologjike ndërtimi dhe koordinim të vazhdueshëm të personelit, makinerive dhe nënkontraktorëve. Për këtë arsye është e domosdoshme që punimet të drejtohen nga një Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë, i cili të garantojë zbatimin e projektit, respektimin e specifikimeve teknike, normave të sigurisë në punë, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe realizimin e punimeve sipas grafikut të zbatimit.

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë pjesë e licencës së shoqërisë synon të garantojë lidhjen e qëndrueshme profesionale ndërmjet operatorit ekonomik dhe personit përgjegjës për drejtimin teknik të punimeve, si dhe të sigurojë disponueshmërinë e tij gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Deklarimi i pranisë së tij gjatë zhvillimit të punimeve është i nevojshëm për të garantuar mbikëqyrjen e vazhdueshme teknike të objektit dhe për të shmangur situatat kur i njëjti specialist angazhohet në mënyrë të tillë që të mos mund të ushtrojë efektivisht përgjegjësitë e tij në këtë kontratë.

Paraqitja e diplomës, librezës së punës dhe kontratës së punës është e nevojshme për verifikimin e kualifikimit profesional, eksperiencës dhe marrëdhënies së punës me operatorin ekonomik, duke krijuar bindjen e nevojshme se ofertuesi disponon kapacitetet profesionale të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i makinerive</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Statusi</b>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Copë	6	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçinë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Kamion me vinç	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Greider	Copë	2	Në pronësi ose me qira
6	Autobot uji	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Autobetoniere	Copë	4	Në pronësi ose me qira
8	Autopompë betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qira
9	Autobitumatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Asfaltoshtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Makineri për vendosje guardrail	Copë	1	Në pronësi ose me qira

13	Eskavatorë me zinxhirë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
14	Minieskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qira
17	Rul gomë-hekur	Copë	2	Në pronësi ose me qira
18	Rul gomë-gomë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
19	Rul hekur-hekur	Copë	2	Në pronësi ose me qira
21	Minifadromë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
22	Makineri vijëzimi me bojë termoplastike (sprajt)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
23	Vinç me kapacitet jo me pak se 20 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
24	Fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
25	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
26	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
27	Autovinc me kapacitet ngritës jo më pak se 20 ton	Copë	2	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.** *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.*

***Argumentimi:***

Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë mjetet, pajisjet teknike dhe burimet materiale të nevojshme për realizimin e kontratës, të cilat i kanë në pronësi, me qira ose që mund t'u vihen në dispozicion nëpërmjet kontratave të furnizimit apo marrëveshjeve të tjera të ligjshme.

Objekti i kësaj kontrate përfshin punime gërmimi, mbushjeje, transporti materialesh, ndërtim të shtresave rrugore, prodhim dhe shtrim asfalti, prodhim dhe vendosje betoni, ndërtim të veprave të kullimit, vendosje të barrierave mbrojtëse (guardrail), sinjalistikë horizontale dhe vertikale, si dhe punime të tjera ndihmëse të parashikuara në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve.

Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të disponojë makineritë dhe pajisjet e kërkuara, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e njëkohshëm të proceseve të ndryshme teknologjike të ndërtimit, për përmbushjen e afateve kontraktore dhe për garantimin e cilësisë së punimeve.

Numri i mjeteve dhe pajisjeve është përcaktuar mbi bazën e:

- volumeve të punimeve të parashikuara në preventiv;
- analizave teknike të zërave të punimeve;
- teknologjisë së zbatimit të punimeve;
- afatit të realizimit të kontratës;
- nevojës për zhvillimin paralel të proceseve të punës në disa fronte pune.

Për përcaktimin e numrit minimal të makinerive dhe pajisjeve janë marrë në konsideratë analizat teknike të punimeve sipas *VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*, e ndryshuar me *VKM Nr. 631, datë 26.10.2018*, si dhe preventivi i hartuar për këtë objekt.

Kërkesa për disponimin e kamionëve vetëshkarkues, eskavatorëve, greiderëve, rulave, autobotëve të ujit, autobetoniereve, autopompave të betonit, autobitumatriçes, asfaltoshtrueses, vinçave, makinerisë për vendosjen e guardrail-it, makinerisë së vijëzimit me bojë termoplastike, si dhe fabrikës së betonit, fabrikës së asfaltit dhe nyjes së inerteve, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në projekt dhe është e nevojshme për realizimin e tyre sipas specifikimeve teknike dhe standardeve në fuqi.

Kërkesa që fabrika e betonit, fabrika e asfaltit dhe nyja e inerteve të jenë të pajisura me Leje Mjedisore me Kod III.1.B vendoset për të garantuar që materialet bazë të përdorura në objekt prodhohen në impiante që ushtrojnë aktivitet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe ligjore për realizimin e punimeve publike.

Autoriteti kontraktor ka parashikuar që mjetet dhe pajisjet të mund të disponohen në pronësi, me qira ose nëpërmjet kontratave të furnizimit, duke mos kufizuar konkurrencën dhe duke u krijuar mundësi operatorëve ekonomikë të provojnë disponueshmërinë e tyre me çdo formë të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën, kompleksitetin, volumin dhe vlerën e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik fitues disponon kapacitetet teknike reale për realizimin cilësor dhe brenda afateve të punimeve.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015      *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2015      *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023      *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.*

### **Argumentimi:**

Në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e certifikatave të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, me qëllim verifikimin e kapaciteteve organizative dhe procedurave të kontrollit që operatori ekonomik zbaton gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimi rrugor me vlerë të konsiderueshme financiare dhe kompleksitet teknik, të cilat kërkojnë standarde të larta organizimi, kontrolli cilësie, mbrojtjeje të mjedisit dhe garantimi të shëndetit e sigurisë së punëmarrësve gjatë procesit të ndërtimit.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) synon të garantojë që operatori ekonomik disponon procedura të dokumentuara për planifikimin, organizimin, kontrollin dhe monitorimin e proceseve të punës, duke siguruar realizimin e punimeve sipas specifikimeve teknike, standardeve të cilësisë dhe kërkesave kontraktore.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve rrugore, të cilat përfshijnë gërmime, transport inertesh, përdorim materialesh ndërtimore dhe procese të tjera që mund të kenë ndikim në mjedis. Kjo certifikatë garanton se operatori ekonomik zbaton procedura për identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë realizimit të punimeve.

Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 45001:2023 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) është e nevojshme për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin aktivitetet e ndërtimit rrugor, përdorimi i makinerive të rënda, punimet në kantier dhe ekspozimi i punonjësve ndaj risqeve të ndryshme profesionale. Kjo certifikatë garanton ekzistencën e procedurave të menaxhimit të

riskut, mbrojtjes së punëmarrësve dhe respektimit të kërkesave ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kërkimi që certifikatat të jenë të lëshuara nga organizma të akredituar synon garantimin e vlefshmërisë, besueshmërisë dhe njohjes së tyre sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, paraqitja e certifikatave nga secili anëtar për pjesën e punimeve që merr përsipër të realizojë është e nevojshme për të garantuar që të gjithë pjesëmarrësit në ekzekutimin e kontratës disponojnë standardet e kërkuara të menaxhimit, në përputhje me natyrën e punimeve që do të kryejnë.

Për rrjedhojë, ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, proporcional me vlerën dhe kompleksitetin e saj dhe synon garantimin e cilësisë së punimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e punëmarrësve gjatë zbatimit të investimit.

**2.4.3** *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

*Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin 2025-2027, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.*

#### **Argumentimi:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se, në rast shpalljeje fitues, do të realizojë punimet brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e investimit, vlerën e konsiderueshme të kontratës, burimin e financimit dhe mënyrën e planifikimit buxhetor të fondit. Objekti i prokurimit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe fondet për realizimin e tij janë parashikuar në programimin buxhetor afatmesëm. Për shkak të vlerës së kontratës, financimi i plotë i saj shtrihet në më shumë se një vit buxhetor, ndërkohë që zbatimi i punimeve do të kryhet sipas afatit kontraktor dhe grafikut të miratuar të punimeve. Paraqitja e deklaratës synon të sigurojë që operatori ekonomik është njohur paraprakisht me skemën e financimit të investimit, me faktin se pagesat do të kryhen sipas fondeve të programuara dhe të miratuara në buxhetin e shtetit, si dhe me detyrimin për të respektuar afatet e realizimit të punimeve të përcaktuara në dokumentet e

tenderit dhe në kontratë. Kjo kërkesë synon të shmangë mosmarrëveshje të mundshme gjatë fazës së zbatimit të kontratës lidhur me mënyrën e financimit të investimit dhe përbën një garanci që operatori ekonomik ka marrë në konsideratë kushtet financiare dhe afatet e realizimit të kontratës përpara paraqitjes së ofertës së tij.

Kriteri nuk krijon barrë financiare apo administrative për operatorët ekonomikë, nuk kufizon konkurrencën dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), si dhe nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP (i ndryshuar). Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike do të hartohen dhe do të argumentohen për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.*

*Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zërat e punimeve janë pjesë e pandarë e DST.*

**Në çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i veçantë pranohen edhe ekuivalent.**